



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:078140

Datë: 29.07.2019

Numri i dokumentit: 00431856

P.nr.881/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshem - me Gjyqtaren Diana Sina, si dhe me procesmbajtësen Lamije Kuqi, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit A. R. nga R., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 pikë 1.4 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/II.nr.1585/2018 të datës 11.12.2018, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, gjykata jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 22.03.2019 mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I Akuzuari:

A. R. nga i ati Sh.dhe e ëma S., e gjinisë Sh., i lindur me dt....., në Ra., ku dhe tani banon në rrugën "E. M."pn. me nr. personal, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa dënuar me parë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse: Me datën 15.10.2018 rreth orës 12:15 min në Gjakovë, në rrugën "... tjetrit i shkakton lëndim të lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm të shëndetit në atë mënyrë që pas një zënke të momentit të krijuar në mes të pandehurit në njërin anë si klient i bankës dhe të dëmtuarit D. U. në anën tjetër në cilësinë e e zyrtarit të P.-C.B. në Gjakovë lidhur me pagesën e një kësti mujor, i pandehuri i ofrohet tek tavolina ku e fyen me fjalë dhe e kap për fyti duke i shqyer kështu edhe këmishën më pastaj e godet me grusht në bark, me çka të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. V. H. me dt.10.11.2018.

- me çka ka kryer veprën penale, lëndim të lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 pikë 1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata ne kuptim të nenit 495 të KPP-së, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti Përgjithshëm, për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP/II.nr.1585/2018 të datës 11.12.2018

Andaj, gjykata ne kuptim të nenit 4, 41, 43 paragrafi 1 pikë 1.3, nenit 46, 73, 74, 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nenit, të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurit i shqipton:

D Ë N I M M E G J O B Ë

Dënim me gjobë në shumën prej 300(treqindë)-€, të cilën dënim duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-së, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej 15(pesëmbëdhjetë) ditësh, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga 20.-€.(njëzet) euro, të gjobës.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale, në emër të akt ekspertimit mjeko ligjor të paguaj shumën prej 20,00 €, dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30,00 €, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

I dëmtuari D. U. nga Gjakova rr. “J. D. R.”NR., kompensimin e dëmit mund ta realizonë në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë–Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën me numër PP/II.nr.1585/2018 të datës 11.12.2018, kundër të pandehurit A. R. nga Rahoveci Rr “E. M.” pn., për shkak të veprës penale, lëndim të lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-së, të cilës ia ka bashkangjitur kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të pandehurit do të shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se i pandehuri ka kryer veprat penale e cila i vihet në barrë.

Pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjinden në shkresat e lëndës, gjyqtari vetëm gjykues gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par.1 të KPP-së dhe në kuptim të nenit 495 par.1 të KPP-së, vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palën e pa udhëzuar është e nevojshme që ti referohet dispozitës së nenit 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-së e cila dispozitë për kryesin e kësaj vepre penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Gjykata vlerëson se provat që janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- Raporti fillestar i incidentit nr. 2018-EA-1129 të dt. 15.10.2018;
- Deklarata e të dëmtuarit D. U. e dhënë në polici me dt.15.10.2018;
- Flash raporti i dt 15.10.2018;
- Raporti i oficerit K. K. #..... të dt.15.10.2018;
- Raporti mjekësorë i Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë të dt.15.10.2018për të dëmtuarin D. U. me nr. 15996;
- Konstatimi dhe mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. V. H. të dt.15.12.2018 për të dëmtuarin D. U.;
- Deklarata e të dyshuarit A. R. e dhënë në polici me dt.15.11.2018; si dhe
- Shkresat tjera përbërëse të lëndës janë provat të mjaftueshme me të cilën argumentohet se i akuzuari është kryes i veprës penale për të cilën pandehet.

Gjykata, këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtin do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, në mënyrë që të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, është marr konform nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragraf 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
Departamenti i Përgjithshëm-
P.nr.881/2018, më datën 22.03.2019.

Procesmbajtësja
Lamije Kuqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Diana Sina

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën Themelore në Gjakovë. Nëse i pandehuri nuk parashtron kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formën e prerë.